A.K.P.A.
Nr 2291 Prot.
Datë,më 22 09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KRISTO ISAK" BERAT**

Nr. 628 prot. Berat, më 19.09.2025

**Lënda:** Njoftim për lëvzje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**

**DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Urdhëzimit nr 759, datë 30.09.2024 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional", Kreu XXII, Neni 119. " Lëvizja paralele e personelit mësimdhënës në ofruesit publikë të AFP- së Shkolla e mesme " Kristo Isak", ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës për pozicionin:

1- Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikës profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizem & Ekonomi Biznes ( me kontrat me afat).

1. **Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
b) të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
e) të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
f) të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Alikanti duhet të plotesojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvleshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së
b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
d) të njohë dhe të përdor programe financiare (financa 5 do jetë përparësi)

## 2. Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass,
c) kartën e identitetit;
d) diplomën e studimeve universitare;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brënda datës 28.08.2025.

3. vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.05.2024, " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e Njësisë së zhvillit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar professional të personelit", i ndryshuar.

**DREJTORI I SHKOLLËS**

**Ferik KOÇI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - SHKOLLA E MESME "KRISTO ISAK" BERAT

Adresa: "Rruga Desaret "
Lagja :"Jani Vruho, Berat »
web: kristoisak.edu.al
Email: kristoisak_berat@yahoo.com
Tel: +355 (0)32 50 2192